

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot.

Korçë, më 18.3.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje serveri fizik”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 48822000-6,
Servera kompjuterikë.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.070.000 (një milion e shtatëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar perkatesisht nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4 me vlerë 21.400 (njëzet e një mijë e katërqind) Lekë (2% të vlerës së përllogaritur të fondit limit).
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP te ndryshuar, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik te ndryshuar”.

L.Duka

K.Bojko

O.Maçura

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

“Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashikimit të nenit 55 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.”

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 61, Ligjin Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

L.Duka

K.Bojko

O.Maçura

3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

L.Duka

K.Bojko

O.Maçura

3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e serverit objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar mallin objekt prokurimi, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës.

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallit që kërkohet në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për mallin e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e mallit dhe nevojës për garanci mbi eficientësinë dhe kapacitetet teknike të pajisjes/mallit.

K.Bojko

3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (nëse katalogët janë në gjuhë të huaj, të përkthehen dhe noterizohen në shqip) për mallin objekt prokurimi. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet teknike të mallit.

Argumentimi: Kriteri është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë produktet, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike si dhe është në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

K.Bojko

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A, në kuadër të përmirësimit dhe garantimit të funksionimit të qëndrueshëm të infrastrukturës së saj të teknologjisë së informacionit, kërkon të realizojë blerjen dhe implementimin e një serveri të ri. Ky server do të përdoret për të mbështetur

shërbimet dhe sistemet e institucionit, duke garantuar performancë, siguri dhe disponueshmëri të lartë të proceseve të punës.

Procesori (CPU)

Procesor serveri me minimumi:

- 10 bërthama fizike dhe 20 threads
- frekuencë bazë minimumi 2.0 GHz dhe frekuencë turbo deri në rreth 3.5 GHz ose më shumë
- mbështetje për teknologji virtualizimi dhe multi-threading
- arkitekturë e gjeneratës së fundit për serverë (enterprise grade)ose ekuivalent

Memoria (RAM)

- Kapacitet i instaluar minimumi 64 GB
- Tipi DDR5 ECC RDIMM ose teknologji ekuivalente për server
- Frekuencë minimumi 4800 MHz
- Mbështetje për konfigurime multi-channel
- Zgjerueshmëri deri në të paktën 4 TB

Storage – Sistemi Operativ dhe Aplikacionet

- 2 × SSD NVMe me kapacitet minimumi 960 GB secili
- Konfigurim RAID 1 për redundancë
- RAID Controller hardware me cache dhe bateri rezervë (BBU) ose mekanizëm ekuivalent për mbrojtje të të dhënave

Storage – Databaza dhe të Dhënat

- 4 × HDD SAS enterprise class me kapacitet minimumi 2 TB secili
- Shpejtësi rrotullimi minimumi 7.2K RPM
- Konfigurim RAID 10 për performancë dhe siguri të të dhënave
- Mbështetje për zgjerim të mëtejshëm në slotet për disqe

Rrjeti

- Minimumi 2 porta rrjeti 10 GbE (SFP+ ose ekuivalente)
- Minimumi 2 porta rrjeti 1 GbE (RJ45 ose ekuivalente)
- Mbështetje për VLAN, LACP, teaming/bonding dhe failover

Slotet e Zgjerimit

- Minimumi 3 slote PCIe për karta zgjerimi (rrjeti, storage ose pajisje të tjera)

Sistemi Operativ dhe Licencimi

- Mbështetje për sisteme operative serveri si Windows Server ose Linux/ekuivalent
- Licencë origjinale e sistemit operativ sipas nevojës së institucionit

Backup dhe Redundancë

- RAID controller hardware me cache dhe mekanizëm mbrojtjeje të të dhënave
- Furnizim energjie redundant (dual power supply)
- Disqe të tipit hot-swap për zëvendësim pa ndërprerje të shërbimit

Pajisja duhet të jetë e tipit server enterprise dhe e re (jo e përdorur), e përshtatshme për implementim në infrastrukturën ekzistuese të institucionit.

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Afati
1	Server	1	1	20 ditë

Afati i lëvrimit: 20 (njëzet) ditë, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Vendi i dorëzimit: Malli do të dorëzohet në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A konform dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe të marrë përsipër në ofertë nga ofertuesi.

K.Bojko